

THIRRJE PËR PROJEKT PROPOZIME Nr. 2

'Dialog për zhvillim politikash gjithëpërfshirëse në Shqipëri -ideAL'

Afati për dorëzimin e Projekt Propozimeve: **31.05.2021**, Ora: **17:00**



Njoftim

Kjo është një thirrje e hapur ku të gjitha dokumentet duhen dorëzuar së bashku.

Vlerësimi i projekt propozimeve përfshin: (a) vlerësimin e përputhshmërisë së dokumentacionit të kërkuar (b) vlerësimin cilësor/përmbajtësor të aplikimit të plotë për aplikantët sipas kritereve të thirrjes vetëm për propozimet të cilat kanë kaluar vlerësimin e përputhshmërisë së dokumentacionit (hapi a).

Udhëzimet e përshkruara në këtë dokument synojnë të ndihmojnë të gjithë aplikantët të dërgojnë aplikimet e tyre në mënyrë korrekte. Ju mund të shkarkoni paketën e aplikimit në faqen e web-it të Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit www.co-plan.org, në faqen e dedikuar të projektit **ideAL** www.ide-al.org, ose të kërkonit paketën e aplikimit duke dërguar një email në adresën: co-plan@co-plan.org.



1. SKEMA E NËN - GRANTIMIT TË PROJEKTIT ideAL

1.1 Racionale për thirrjen e dytë për projekt propozime

'Dialog për zhvillimin gjithëpërfshirës të politikave të bazuara në prova në Shqipëri – **ideAL**' vjen si një përpjekje e përbashkët e Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, dhe Qendrës së Politikave Evropiane (EPC, Belgjikë), mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian.

Ky projekt synon të kontribuojë në përmirësimin e dialogut të politikave publike në Shqipëri, përmes: (a) forcimit të dialogut të politikave publike në proceset e reformës; (b) lehtësimit të përfshirjes së shoqërisë civile në proces dhe dialog me politikë-bërës¹.

Për të arritur këtë qëllim, ideAL parashikon të punojë ngushtësisht me aktorë nga shoqëria civile (*organizata apo individë – të cilësuar si aktorë jashtetërorë*) për t'i mbështetur me aftësim teknik dhe financiar në procesin e ndërveprimit dhe dialogimit me *politikëbërës e vendimmarrës vendorë apo qendrorë (aktorë shtetërorë)*, në faza të ndryshme të ciklit të politikëbërjes.

Përgjatë vitit 2020, ideAL shpalli thirrjen e parë për projekt propozime, përmes së cilës u mbështetën 5 nisma.

Për t'u njohur më mirë me gjendjen aktuale të punës kërkimore në politika publike, sfidat dhe nevojat e shoqërisë civile të angazhuar në këtë fushë (*përfshirë këtu organizata dhe individë*), krahas procesit të vlerësimit të nevojave të aktorëve jashtetërorë, janë kryer disa procese konsultimi, gjetjet e të cilave janë përdorur për të formëzuar këtë thirrje të dytë për projekt propozime.

1.2 Objektivat e Thirrjes

Objektivat e kësaj thirrjes për projekt-propozime janë:

- Të lehtësojë përfshirjen e shoqërisë civile në proces dhe dialog me politikëbërës² në sektorë politikash me prioritet për agjendën e zhvillimit dhe integritet të vendit në Bashkimin Evropian.
- Të aftësojë aktorë të shoqërisë civile (*përfshirë këtu organizata dhe individë*) me njohuri teknike dhe mbështetje, në fushën e advokimit dhe ndikimit në politikëbërje;

Fushat prioritare për këtë thirrje janë të shpjeguara më poshtë. Për secilën prej fushave do të gjeni aspekte ilustrative/orientuese, të cilat nuk kanë për qëllim të jenë shteruese. **Mirëpritën projekt-propozime në aspekte të tjera të parëndësishme më poshtë në shpjegimin për çdo fushë prioritare, për sa kohë janë të lidhura me fushën/fushat prioritare dhe janë në përputhje të plotë me kriteret e thirrjes.**

1. **Mirëqenia dhe mbrojtja sociale** – fokusuar kryesisht në aspekte lidhur me strategjinë kombëtare për mbrojtjen sociale, aftësia e kufizuar, varfëria dhe skema e ndihmës ekonomike, shërbimet e kujdesit shoqëror, çdo çështje tjetër me relevance të lartë për kontekstin në fushën e mbrojtjes sociale.

¹ Përfshirë këtu Institucionet shtetërore qendrore dhe vendore

² Përfshirë këtu Institucionet shtetërore qendrore dhe vendore

2. **Mbrojtja Civile** – fokusuar kryesisht në aspekte lidhur me manaxhimin në nivel qendror dhe vendor të emergjencave civile si fatkeqësitë natyrore, përmytjet, zjarret, rrëshqitjet, pandemitë (p.sh. COVID-19).
3. **Edukimi** – fokusuar kryesisht në aspekte si: edukimi digjital në të gjitha nivelet e arsimit, strategjia e arsimit para-universitar dhe reforma e arsimit të lartë; formimi profesional dhe zbatimi i akteve nënligjore, zbatimi i kurrikulave në arsimin parashkollor, aftësimi i të rinjve për punësim, buxheti i alokuar për arsimin, etj.
4. **Zhvillimi Ekonomik** – fokusuar kryesisht në aspekte të lidhura me (i) zhvillimin e turizmit; (ii) zhvillimin rural:
 - 4.1 Zhvillimi i Turizmit** – fokusuar në aspekte si: monitorimi i zbatimit të Objektivave Strategjike të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Turizmit të Qëndrueshëm në Shqipëri 2019 – 2023; rekomandime apo nisma të reja për përmirësimin e kornizës ligjore për zhvillimin e turizmit të brendshëm, zhvillimin e turizmit cilësor dhe të sigurt; monitorim të zbatimit të Ligjit nr. 93/2015 'Për Turizmin' dhe akteve të tij nënligjore; rekomandime apo nisma të reja për mbështetjen e sektorit të turizmit veçanërisht lidhur me efektet e COVID-19; ngritja dhe adresimi i sfidave në sektorin e turizmit si: prioritete zhvillimi konfliktuese (zhvillimi i sektorit të *energjisë* vs. zhvillimi i turizmit), *informaliteti i lartë në sektorin e turizmit*; baza të dhënash të paplota dhe inkonsistente nga institucione të ndryshme; etj.
 - 4.2 Zhvillimi Rural** - fokusuar në aspekte si: hartimi dhe zbatimi i kornizës ligjore për produktet organike dhe përcaktimet e mbrojtura të origjinës, indikacionet gjeografike dhe specialitetet tradicionale të garantuara; (si psh. vreshtat, vera, etj.); informaliteti në sektor; aspekte nga ligji për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor; digjitalizimi dhe mekanizimi në sektor, etj.
5. **Mjedisi, Ndryshimet Klimatike dhe Reduktimi i Riskut** – fokusuar kryesisht në aspekte si ndryshimet klimatike, zhvillimi i qëndrueshëm, mbrojtja e mjedisit, cilësia e ujit dhe ajrit, ndotja akustike, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja e natyrës, ndotjet industriale, shërbimet e ekosistemit urban dhe rural, ekonomia qarkulluese, mobiliteti-aksesueshmeria, dekarbonizimi i sektorëve privat-publikë, efienca e energjisë në procese, produkte dhe banesa, etj. Gjithashtu edhe çështje horizontale si, identifikimi dhe vlerësimi i implikimeve socio-ekonomike dhe mjedisore nga përafrimi dhe më tutje zbatimi i Direktivave dhe Rregulloreve të EU/EC, sa i takon kapitullit 27 & 15;
6. **Decentralizimi dhe qeverisja** – fokusuar kryesisht në aspekte si: rekomandime për konsolidimin e mëtejshëm të reformës administrative territoriale; vlerësim të zbatimit të agjendës më të gjerë të decentralizimit; analizë dhe rekomandime për përmirësimin e autonomisë fiskale lokale; analizë dhe rekomandime për përmirësimin e shërbimeve publike në vend; monitorim dhe vlerësim të efektivitetit të pjesëmarrjes qytetare në vendim-marrje lokale;
7. **Reforma në Administrim Publik** – fokusuar kryesisht në aspekte si: vlerësim i ecursë së reformës në administratën publike; vlerësim i zbatimit dhe efektivitetit të strategjive të reformës së menaxhimit publik-financiar përfshirë ndikimin e procesit të riorganizimit të portofoleve dhe strukturave ministrore; monitorim të ecursë të zbatimit të vlerësimeve

rregullative dhe buxhetore të ndikimit në të gjitha ministritë për të përmirësuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë financiare të propozimeve legislative dhe të politikave; rekomandime për përditësimin e kornizës rregullore për planifikimin dhe monitorimin e politikave dhe përhapjen e sistemit të integruar të bërjes së politikave; rekomandime për zhvillimin e një politike pagash për nëpunësit civilë; monitorim të ecurisë së lidhjes së sistemit të informacionit për menaxhimin e burimeve njerëzore me thesarin për të siguruar një sistem pagesash të automatizuar.

8. **Strehimi Social** – fokusuar kryesisht në aspekte si: monitorimi i zbatimit të Ligjit nr. 22/2018 'Për Strehimin Social'; monitorimi i zbatimit të Strategjisë Sociale për Strehim 2016-2025; monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit 10 vjeçar në mbështetje të zbatimit të strategjisë; analiza e investimeve në sektorin e strehimit; analiza e instrumenteve financiare në mbështetje të nevojave për strehim; analiza të thelluara të kërkesës dhe ofertës për strehim social në nivel vendor (për bashki të caktuara); vlerësim të kuadrit ligjor dhe institucional me rekomandime të qarta për rritjen e qasjes në strehim; vlerësim të efektivitetit të ndërveprimit midis institucioneve në nivel qendror dhe vendor në procesin e shpërndarjes së strehimit në 61 njësitë vendore; analiza të thelluara të efektivitetit të marrëveshjeve të partneritetit publik-privat (ppp) për përmirësimin e alternativave të strehimit social; vlerësim të efektivitetit të strategjisë veçanërisht lidhur me pasojat e rënda të tërmetit të 26 Nëntorit 2019, në fushën e strehimit; propozim për ndërmarrje të nismave të reja ligjore në mbështetje të strehimit të përballueshëm, etj.

Fushat e mësipërme duhet të trajtohen në një nga dy format e mëposhtme:

1. **Vlerësim i politikave në përgjigje të kërkesave të institucioneve publike** (*Rapid Response Policy Assessment*) të fokusuara në çështje të qeverisjes vendore, apo qeverisjes qendrore – *Projekte për zbatim vetëm nga organizata (persona juridikë)*. Nëse çështja ka në fokus qeverisjen vendore, ajo duhet të ketë rëndësi për të gjitha njësitë vendore dhe jo për një bashki të vetme.

2. **Qasje e lirë me fokus në dialog, hulumtim dhe advokim të politikave**, bazuar në agjendën e politikave dhe me pikënisje në një fazë çfarëdo të ciklit të politikave, të nivelit vendor ose qendror. Projekte mund të vijnë nga:

(2.1) Hulumtues/ekspertë individë në bashkëpunim me një organizatë ose universitet/qendër kërkimore, ose

(2.2) Organizata

Në çdo rast, kohështrirja e projekteve të propozuara duhet të jetë **nga 8 -10 muaj**.

1.3 Fondi në dispozicion për këtë thirrje

Shuma totale e vënë në dispozicion për këtë thirrje për propozime është **254,990 EUR**. Varësisht cilësisë së propozimeve, rezervohet e drejta të mos *akordohen* të gjitha fondet në dispozicion të kësaj thirrje.

Projekt-propozimet duhet të respektojnë shumën minimale dhe maksimale të lejueshme:

- Shuma minimale: 6,000 EUR



- Shuma maksimale: 12,000 EUR për individë dhe 30,000 EUR për organizata.

Çdo projekt propozim fitues do të financohet në masën 100% të kostove totale të lejueshme të projektit (*referoju seksionit 2.1.3*).



2. RREGULLAT PËR KËTË THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME

Këto udhëzime përcaktojnë rregullat për dorëzimin, përzgjedhjen dhe zbatimin e aktiviteteve të financuara në kuadër të kësaj Thirrje për Propozime.

2.1 KRITERET E LEJUESHMËRISË

Vlerësohen në tre nivele:

- **Kush mund të aplikojë?**
Sqarohet në seksionin 2.1.1;
- **Çfarë aktivitete mbështeten financiarisht?**
Sqarohet në seksionin 2.1.2;
- **Çfarë kostosh lejohen?**
Sqarohet në seksionin 2.1.3;

2.1.1. Kush mund të aplikojë?

Lejohen të aplikojnë:

- (1) Persona juridikë (*organizata*), ose persona natyrorë (*individë*);
- (2) Në rastin e një personi juridik:
 - Të jetë një organizatë e shoqërisë civile, e regjistruar si jo-fitimprurëse, sipas legjislacionit shqiptar për organizatat jofitimprurëse
 - Të jetë themeluar dhe të operojë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- (3) Në çdo rast, të jetë pa precedent penal në veprimtari mashtrimi apo korrupsioni.
- (4) Në çdo rast, të mos jetë përfshirë në veprimtari fetare;
- (5) Të mos jetë grupim/parti/entitet politik;

Në rastin e një aplikimi nga një person natyror, do duhet që aplikimi të shoqërohet nga një letër mbështetëse nga grupi mandatues që aplikanti përfaqëson.

Mirëpritën aplikime nga:

- Organizata të shoqërisë civile,
- *Think tanks*,
- Institute kërkimore,
- Shoqata, unione, apo entitete të ngjashme
- Studiues të pavarur,
- Ekspertë të fushave të ndryshme të angazhuar në procese hulumtimi të politikave publike në shqipëri,
- Aktivistë,
- Analistë,
- Gazetarë që mbulojnë tema/çështje në ciklin e politikave,



- Akademikë, etj.

Inkurajohen partneritetet veçanërisht me institucionet lokale ose qendrore:

Aplikanti mund të aplikojë i vetëm ose në bashkëpunim me partnerë. Bashkë-aplikantët, në rast se ka, duhet të plotësojnë të njëjtat kritere sikurse dhe vetë aplikanti.

E rëndësishme: Do të shihen me prioritet ato aplikime të cilat sjellin bashkë aplikantin dhe një grupim të caktuar përfshirë këtu, partneritete me unione, sindikata, grupe interesi, grupe lokale, media, institute kërkimore, grupime të caktuara profesionale, etj.

Numri i Granteve për Aplikant dhe bashkë-aplikant:

Aplikuesi (pavarësisht rolit: aplikant apo bashkë-aplikant) mund të aplikojë vetëm me një aplikim në këtë thirrje. Kjo vlen për organizatat dhe për individët.

2.1.2 Çfarë aktivitete mbështeten financiarisht?

Llojet e aktiviteteve që mbështeten janë:

- Aktivitete advokimi për politika publike, sipas Figurës 3. Aktivitete të advokimit, audienca e synuar dhe ndryshimi në politikëbërje për sa kohë që nuk synojnë lobimin politik dhe mbështetje për forcat politike, etj;
- Vlerësim të politikave në përgjigje të kërkesave të Institucioneve publike (qeveria, parlamenti, etj.)
- Zhvillim të dokumenteve të politikave;
- Raporte të shkurtra analitike për reforma sektoriale apo politikëbërjen në një sektor;
- Vlerësime dhe rishikime të politikave;
- Raporte monitorimi politikash;
- Roadmaps ose programe për reforma urgjente demokratike dhe / ose qeverisjeje;
- Raste studimore;
- Sondazhe, vlerësime, vëzhgime në funksion të procesit të hulumtimit të politikave publike;
- Organizim të konferencave tematike / aktiviteteve publike;
- Pjesëmarrje në debate publike, në seanca parlamentare, në takime publike të institucioneve publike, në media televizive / radio, online, etj.;
- Punë në terren që kërkohet për të mbledhur informacione për përmirësimin e politikave;
- Aktivitete të tjera të ngjashme të lidhura dhe në mbështetje të fazave të ndryshme të ciklit të politikave;

Vizibiliteti: Aplikantët pavarësisht aktivitetit, duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të publikuar/ paraqitur faktin që Bashkimi Evropian është financuesi i nismave/projekteve nëpërmjet projektit ideAL.

E rëndësishme: Varësisht dhe në përputhje me politikat në zbatim për parandalimin dhe/ose zbutjen e përhapjes/efekteve të COVID-19, në çdo rast, aktivitetet e propozuara do duhet të marrin në konsideratë kufizimet e mundshme dhe të propozojnë mënyra alternative të lejuara për të siguruar vazhdimësinë dhe zbatimin me eficiencë të plotë të aktiviteteve të parashikuara.


ASPEKTE ME RËNDËSI PËR T'U PASUR PARASYSH:

Pavarësisht fushës së zgjedhur, çdo projekt do të duhet të shpjegojë dhe argumentojë qartë:

1. Interesat dhe mandatin e grupit të synuar që përfaqëson.


Në cilën fazë të Ciklit të Politikave (Shihni Figura 1. *Cikli i Politikave*) e ka pikënisjen ndërhyrja dhe në cilën fazë parashikon të arrijë. Në çdo rast, do duhet që çdo projekt-propozim të parashikojë mbulimin e të paktën 2 fazave në Ciklin e Politikave dhe ndërhyrja nuk mund të ketë si mbyllje vetëm "Përcaktimin e Agjendës". Si rregull, asnjë ndërhyrje nuk mund të fillojë me "rishikim" të politikës, pasi nëse ky është rasti nevojitet të realizohet më parë vlerësimi.

Figura 1. *Cikli i Politikave*




- Në rastin e projekt-propozimeve që zgjedhin të trajtojnë fushën **Vlerësim i politikave në përgjigje të kërkesave të institucioneve publike** (*Rapid Response Policy Assessment*), pikënisja e ndërhyrjes është në fazën "Vlerësimi" të Ciklit të Politikave dhe duhet të përfundojë minimalisht në fazën e "Formulimit", ose në faza që vijnë pas "Formulimit".
- Çdo projekt-propozim, pavarësisht temës, duhet të përmbajë aktivitete për advokim në politikëbërje, pasi qëllimi final i ndërhyrjeve është dialogimi mes aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë për ndikim në politika publike. Në projekt-propozim do të duhet të dalë qartë se në ç'mënyrë ndërhyrja parashikon të realizojë ciklin e plotë të advokimit. Skema në vijim mund të përdoret si referencë për të shpjeguar fazë pas faze se si projekti parashikon në mënyrë konkrete t'a kryejë të plotë ciklin.

Figura 2. Cikli i Advokimit në Politikëbërje



4. Pavarësisht fushës prioritare, çdo projekt-propozim duhet të përcaktojë dhe shpjegojë qartë me cilën audiencë parashikon të punojë dhe çfarë ndryshimi synon të arrijë në politikëbërje. Shpjegimi duhet të jetë sa më i qartë dhe konkret për kontekstin, mundësisht duke përdorur si referencë matricën më poshtë:

Figura 3. Aktivitete të advokimit, audiencia e synuar dhe ndryshimi në politikëbërje³.



³ Përkthyer dhe përshtatur nga <https://courses.philanthropyu.org>.

5. Çdo projekt propozim duhet të artikulojë qartë kuadrin politik dhe ligjor mbi të cilin ndërton, përputhshmërinë me strategjitë, prioritetet dhe legjislacionin vendas, si dhe ato të Bashkimit Europian. Problemi i adresuar duhet të jetë i qartë në projekt-propozim dhe projekt-propozimi nuk duhet të përmbajë aktivitete për të identifikuar/zbuluar problemin gjatë zbatimit të ndërhyrjes.

Aktivitete që nuk financohen:

- Aktivitete që nuk përputhen me objektivat e kësaj thirrje;
- Aktivitete të lidhura vetëm ose kryesisht me bursa individuale për pjesëmarrje në *workshope*, seminare, konferenca, kongrese;
- Shërbime konsulence;
- Projekte që mbështesin aktivitete ilegale, dhe aktivitete fetare;
- Mbulimin e humbjeve apo shlyerje detyrimi të prapambetur të një organizate;
- Subvencionim të organizatave të tjera;
- Blerje të tokës, ndërtesave dhe zyrave;
- Shpenzime të prapambetura për projekte që janë në zbatim ose të përfunduara;
- Aktivitete që zhvillohen jashtë Shqipërisë;
- Aktivitete Humanitare;
- Financimin e aktiviteteve të partive politike përfshirë fushata elektorale, etj.
- Lobimin për partitë politike;
- Aktivitete që ofrojnë mbështetje financiare ndaj palëve të treta;

2.1.3. Çfarë kostosh lejohen?

Një grant mund të mbulojë vetëm 'kostot e lejueshme'. Kategoritë e kostove që janë të lejueshme dhe jo të lejueshme renditen më poshtë.

Kostot e lejueshme janë:

- Kostot të cilat janë të përfshira në buxhetin e projektit;
- Kostot që kryhen gjatë zbatimit të projektit;
- Kostot në lidhje me shërbimet & punët dhe që lidhen me aktivitetet e kryera gjatë periudhës së zbatimit të projektit;
- Shpenzimet e kryera të cilat paguhet para datës së mbylljes së projektit;
- Kosto të cilat janë të verifikueshme dhe të identifikueshme⁴.
- Kostot janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit fiskal dhe sigurimet shoqërore;
- Kostot janë të arsyeshme, të justifikuar dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit financiar, në veçanti përsa i përket anës ekonomike dhe efijencës.

Kosto të palejueshme janë:

- Taksat, përfshirë taksën e vlerës së shtuar (TVSH);
- Kredi për të tretët;
- Shpenzimet e deklaruara nga zbatuesi dhe të mbuluara nga një projekt apo program tjetër;

⁴ Veçanërisht ato regjistrohen në librat e kontabilitetit të përfutësit dhe përcaktohen në përputhje me standartet shqiptare të kontabilitetit dhe me praktikën e zakonshme të kontabilizimit të kostove të zbatuesit (ve) të projektit;

- Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet gjyqësore;
- Doganat dhe tarifat e importit, ose çdo detyrim tjetër;
- Komisionet bankare (përveç kostove të mirëmbajtjes së llogarisë bankare), shpenzimet e garancive dhe detyrime të ngjashme;
- Shpenzime për këmbime, detyrime dhe humbje në këmbim që lidhen me ndonjë komponent specifik të llogarisë në euro, si dhe shpenzime të tjera të pastra financiare;
- Shpenzime amortizimi;
- Borxhet dhe komisionet për trajtimin e borxhit;
- Borxhe dhe interesa të borxhit;
- Dispozitat për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen;

Rreth Buxhetit:

Rimbursimi i kostove të lejueshme do të bazohet në buxhetin e aprovuar, të specifikuar në njësi dhe kosto për njësi.

Autoriteti Kontraktues vendos nëse do të pranojë shumat e propozuara sipas buxhetit fillestar të paraqitur nga aplikanti, duke analizuar të dhënat faktike të granteve të kryera nga aplikuesi ose nga projekte të ngjashme.

Në 'Shtojcën B: Buxheti', "Justifikimi i kostove të paraqitura", për çdo zë të buxhetit aplikanti duhet të:

- Përshkruajë informacionin dhe metodat e përdorura për të përcaktuar koston për njësi, kostot e padetajuara (*lumpsum*) dhe/ose normat fikse (*flat rates*), të kostove që ju referohen;
- Shpjegojë qartë formulat e përdorura për llogaritjen e shumave finale të lejueshme.

E rëndësishme: Për çdo aspekt të paqartë, palët e interesuara mund të dërgojnë pyetjet e tyre me e-mail drejtuar co-plan@co-plan.org, jo më vonë se 20 Maj, 2021 duke vendosur qartësisht numrin referent të Thirrjes për Projekt – Propozime. Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit si Autoriteti Kontraktues nuk ka asnjë detyrim të japë sqarime ndaj pyetjeve të dërguara pas kësaj date.

Përgjigjet do të jepen jo më vonë se 3 ditë nga momenti i marrjes së pyetjeve. Për të garantuar një trajtim të barabartë të aplikantëve, Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit nuk mund të japë një opinion paraprak mbi pranueshmërinë e aplikantëve, projektin apo aktivitetet specifike. Pyetjet që mund të jenë me interes dhe në shërbim edhe për aplikantët e tjerë, së bashku me përgjigjet, do të publikohen në faqen e internetit të projektit [ideAL: www.ide-al.org](http://www.ide-al.org). Prandaj, është e këshillueshme që të konsultoheni rregullisht me faqen e internetit në fjalë në mënyrë që të jeni të informuar për pyetjet dhe përgjigjet e publikuara.

2.2. SI TË APLIKONI DHE PROCEDURAT QË DUHET TË NDIQNI

- Aplikimet për projekt propozime duhet të dorëzohen në përputhje të plotë me udhëzimet në Thirrjen për Propozime.
- Aplikantët duhet të përgatisin dhe të dorëzojnë aplikimet e tyre **në gjuhën shqipe, me një përmbledhje në gjuhën Angleze** (pjesë integrale e Formularit të Aplikimit).
- Çdo gabim apo mospërputhje në lidhje me pikat e renditura në udhëzim për formularët e aplikimit mund të rezultojnë në refuzimin e aplikimit.
- Sqarime do të kërkohen vetëm kur informacioni i dhënë është i paqartë duke e penguar Autoritetin Kontraktues të bëjë një vlerësim objektiv.

Çfarë dokumentesh mbështetëse duhen paraqitur?

Që projekt-propozimi të konsiderohet i plotë, duhet të shoqërohet nga dokumentet mbështetëse të renditura si më poshtë.

Në rastin e aplikantëve *persona juridikë (OJF)*

- Vendimi i regjistrimit në gjykatë (kopje);
- Statuti dhe Akti i Themelimit të organizatës (kopje);
- Regjistrimi (NIPT) në Zyrën e Taksave dhe Tatimeve (kopje);
- Profili Organizativ ku evidentohet qartë përvoja e punës në fushën e hulumtimit të politikave publike, advokimit ose/dhe lobimit.

Në rastin e aplikantëve individë, *persona natyrorë*:

- Kopje e Kartës së Identitetit;
- Llogari Bankare në emër të individit aplikues;
- CV e plotë;
- Kopje e Diplomës/Diplomave;
- Marrëveshje Bashkëpunimi ose Letër Mbështetëse nga organizata /institucioni partner apo grupi mandatues;
- Shembuj punësh të mëparshme përfshirë, artikuj, studime, dokumente politikash, etj.

E rëndësishme: Sigurohuni që po dorëzoni të gjitha dokumentet mbështetëse. Aplikimet jo të plota dhe që nuk plotësojnë rregullat e vendosura do të refuzohen.

Kur dhe si të dërgohen Aplikimet?

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data 31 Maj 2021, brenda orës 17:00. Çdo aplikim i dorëzuar pas afatit të përcaktuar do të refuzohet automatikisht.

Aplikimi do të kryhet elektronikisht në adresën: co-plan@co-plan.org. Një e-mail konfirmues do t'i dërgohet çdo aplikanti për të konfirmuar marrjen e aplikimit. Nëse nuk merrni e-mail konfirmues nga adresa zyrtare e Co-PLAN co-plan@co-plan.org brenda ditës së aplikimit, do të thotë që ne nuk e kemi marrë aplikimin tuaj.



Në aplikim do duhet të përfshihen krahas formularëve dhe dokumentet mbështetëse. Ndonëse ky nuk është një kriter skualifikues, për lehtësi komunikimi dhe garanci në marrjen e tij në kohë, do t'ju inkurajonim që, në tërësi, aplikimi të jetë jo më shumë se 10 Mgb.



2.3 VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKIMEVE

Të gjitha projekt - propozimet e bëra nga aplikantët do të kalojnë në 2 faza vlerësimi sipas kriterëve dhe hapave të mëposhtëm:

1- Hapja dhe Kontrolli Administrativ

Më poshtë do të vlerësohen:

Kriteret Administrative	Po	Jo	Komente
1. Propozimi është dorëzuar brenda afatit.			
2. Aplikimi ka respektuar formatin e kërkuar.			
3. Propozimi është në gjuhën shqipe dhe shoqërohet nga një përmbledhje në gjuhën angleze.			
Dokumentet Mbështetëse	Po	Jo	Komente
Aplikanti person juridik (OJF) ka paraqitur: - Vendimi i regjistrimit në gjykatë (kopje); - Statuti dhe Akti i Themelimit të organizatës (kopje); - Regjistrimi (NIPT) në Zyrën e Taksave dhe Tatimeve (kopje); - Profili Organizativ ku evidentohet qartë përvoja e punës në fushën e hulumtimit të politikave publike, advokimit ose/dhe lobimit. Aplikanti person natyror (individ) ka paraqitur: - Kopje e Kartës së Identitetit; - Llogari Bankare në emër të individit aplikues; - CV e plotë; - Kopje e Diplomës/Diplomave; - Letër mbështetëse nga grupi mandatues; - Shembuj punësh të mëparshme përfshirë, portofol artikujsh, studimesh, dokumente politikash, etj.			
<i>Buxheti, kohëzgjatja dhe nr. i aplikimeve</i>			
Buxheti total i projektit është brenda limiteve të kërkuara (minimumi 6,000 Euro dhe maksimumi 30,000 Euro.			
Kohëzgjatja e projektit është nga 8 muaj në 10 muaj.			
Aplikanti ka paraqitur vetëm një aplikim (ose si Aplikant, ose si Bashkë-Aplikant).			

Vlerësimi cilësor/përmbajtësor nuk do të kryhet për projekt-propozime që nuk përmbushin kriteret e kontrollit administrative.

Vlerësimi Cilësor/Përmbajtësor i Aplikimit të Plotë

Cilësia e aplikimeve, duke përfshirë buxhetin e propozuar dhe kapacitetin e aplikantëve, do të vlerësohet duke përdorur kriteret e vlerësimit të plotë që janë në tabelën më poshtë:

1. Relevanca.	50
1.1. Sa e rëndësishme dhe urgjente është çështja në fokus të propozimit në kontekstin shqiptar? Sa kontribuon çështja në fokus të propozimit në procesin e integritit në Bashkimin Europian?	10
1.2 A ndërtohet projekt propozimi mbi një interes/mandat të qartë të një grupi të caktuar interesi?	10
1.3 A i përcakton qartë propozimi fazat e ciklit të politikave që ka në fokus (sipas figurës 1)?	10
1.4 A parashikon projekt propozimi aktivitete për advokim në politikëbërje (sipas figurës 2)?	10
1.5 A është përcaktuar qartë audienca e synuar dhe ndryshimi i pritshëm në politikëbërje?	10
2. Kapaciteti financiar dhe operacional i aplikantit dhe bashkë-aplikantit (nëse ka) në zbatimin e projekt – propozimit.	15
2.1. A ka Aplikanti përvojë të mjaftueshme të provuar në menaxhimin e projekteve të ngjashme me projektin e propozuar?	5
2.2. A ka Aplikanti përvojën dhe kapacitetet e mjaftueshme në menaxhimin e projekteve të së njëjtës madhësi granti?	5
2.3. A ka stafi i propozuar ekspertizën teknike të mjaftueshme dhe aftësitë për të zbatuar projektin?	5
3. Efektiviteti dhe zbatueshmëria e projektit	10
3.1 Është plani i veprimit i qartë dhe i zbatueshëm?	5
3.2 A përmban propozimi tregues (indikatorë) objektivisht të verifikueshëm për rezultatet e projektit?	5
4. Impakti i pritshëm i projektit	15
4.1. A ka projekti një ndikim të prekshëm në grupet e targetuara dhe përfituesit e tij (a e impakton projekti pozitivisht grupin të cilin përfaqëson dhe a është ky impakt qartësisht i përshkruar dhe matur)?	15
5. Buxheti dhe efektiviteti i kostove të projektit	10
5.1. A janë aktivitetet e reflektuara në mënyrën e duhur në buxhet?	5
5.2. A është raporti ndërmjet kostove të paraqitura dhe rezultateve të pritshme i kënaqshëm?	5
PIKËT TOTALE MAKSIMALE	100

Numri minimal i pikëve të domosdoshme për t'u konsideruar në këtë fazë '*Vlerësimi Cilësor/Përmbajtësor*' është 65 pikë.

Njoftimi për rezultatet dhe mundësia për ankimim

Aplikantët do të njoftohen me shkrim për vendimin e Autoritetit Kontraktues në lidhje me aplikimin e dorëzuar. Kjo letër do të dërgohet me e-mail.

Një aplikant që beson se është vlerësuar negativisht si rezultat i ndonjë gabimi apo parregullsie gjatë procesit të vlerësimit mund të bëjë ankimim brenda 5 (pesë) ditëve (ditë pune) nga dita që ka marrë njoftim për refuzim. Ankimimi do të shqyrtohet dhe përgjigja do të kthehet brenda 5 ditëve (ditë pune) që nga paraqitja me shkrim e ankimimit.

Kontraktimi

Para nënshkrimit të kontratës, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën për të negociuar me aplikuesin në mënyrë që të sigurojë efikasitetin maksimale të kostove të projektit. Pas përfundimit të hapave të mësipërm, do të kryhet nënshkrimi i kontratës ndërmjet aplikuesit përkatës dhe Autoritetit Kontraktues.



KALENDAR INDIKATIV I PROCESIT		
	Data	Ora
<i>Shpallja publike e Thirrjes për Projekt - Propozime</i>	<i>20 Prill 2021</i>	<i>17:00</i>
<i>Afati i fundit kohor për t'i drejtuar pyetje sqaruese Autoritetit Kontraktues</i>	<i>20 Maj 2021</i>	<i>17:00</i>
<i>Data e fundit në të cilën publikohen sqarimet nga Autoriteti Kontraktues</i>	<i>25 Maj 2021</i>	<i>17:00</i>
<i>Afati i fundit kohor për dërgimin e Aplikimeve</i>	<i>31 Maj 2021</i>	<i>17:00</i>
<i>Informimi i aplikantëve mbi vlerësimin e aplikimit të plotë</i>	<i>7 Korrik 2021</i>	-
<i>Afati i fundit në dispozicion për ankimim</i>	<i>14 Korrik 2021</i>	
<i>Firmosja e Kontratave</i>	<i>30 Korrik 2021</i>	-

4. LISTA E ANEKSEVE

DOKUMENTAT PËR T'U PLOTËSUAR

SHTOJCA A: Forma e Aplikimit të Grantit (Format Ëord)

SHTOJCA B: Forma e Propozimit të Buxhetit (Format Excel)

